

VENDIM
Nr. 475, datë 3.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN DHE LLOGARITJEN E AFATEVE TË PAGIMIT TË
ÇMIMIT TË TRUALLIT, PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI
TRUALLIN SHTETËROR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 310, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Çmimi i truallit së njësisë së ndërtuar apo vlera e pjesës takuese paguhet në mënyrë të vetme, duke u reduktuar në masën 10 (dhjetë) për qind, nëse pagesa kryhet brenda 1 (një) muaji, nga njoftimi me shkrim, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Nëse pagesa e plotë apo e pjesës takuese të çmimit të truallit nuk kryhet brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, në zbatim të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, mbi vlerën e detyrimit llogaritet penalitet në masën 10 (dhjetë) për qind të çmimit total të truallit ose pjesës takuese, për çdo muaj vonesë, me kusht që masa e penalitetit të mos e kalojë këtë çmim, apo vlerën e pjesës takuese, sipas rastit.”.

3. Pika 6 shfuqizohet.

4. Në pikën 7 fjalët “...brenda afatit të përcaktuar...” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama